



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**KËSHILLI DREJTUES**

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

**VENDIM**

**Nr.2, datë 30.01.2024**

**PËR**  
**SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË**  
**TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**PËR VITET 2024 - 2026**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “r” të Statutit të Agjencisë, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Komitetit të Strategjisë në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, i ngritur me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 2, datë 31.01.2023, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e “Planit Strategjik të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitet 2024 - 2026”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen njësitë organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar

